



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 08.07.2025
Numër Protokoli: 5050/2025

A.nr.968/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, dhe Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.968/2025, të datës 26.05.2025, të parashtruar nga ankuesja D.K kundër organit të punësimit/Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 08.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.968/2025, e datës 26.05.2025, e parashtruar nga ankuesja, D.K.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi i datës 07.05.2025, lidhur me rezultatet përfundimtare për procedurën e pranimit sipas konkursit Nr.01/2025, pozita *Udhëheqës i Zyrës për Informim dhe Komunikim me Media* në Gjykatën Themelore në Pejë, të shpallur më datë 05.02.2025, nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, D.K.(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), më datë 26.05.2024, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër refuzimit të aplikacionin në procedurën e pranimit sipas konkursit Nr.01/2025, të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor më datë 05.02.2025, për pozitën *Udhëheqës i Zyrës për Informim dhe Komunikim me Media* në Gjykatën Themelore të Pejës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 02.06.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës (SKGJK), ndërsa, kjo e fundit, më datë 03.06.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku dokumentacionin referuar procedurës së kontestuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 3481/2025 të parashtruar nga ankuesja më datë 26.05.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërtetimin me Nr. 15 të datës 20.03.2025, të lëshuar për ankuesen nga Radio Peja; Kopjen e ID-së së ankueses; Pasqyrën nga Trust për ankuesen për periudhën 20.03.2019 deri 19.03.2025; Diplomën me Nr. 43 të datës 31.07.2019; konkursin e jashtëm Nr. 01.2025 i datës 05.02.2025; Certifikatën me Nr. 16/2023 të datës 26.05.2019 për dhënien e provimit të Jurisprudencës; Listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet për testim me shkrim; Përgjigjen në kërkesë e datës 25.03.2025 nga Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për ankuesen; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.06.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 03.06.2025; Vendimin Referencë DS-203/2025 i datës 18.04.2025 për emërimin e Komisionit të Pranimit; Njoftimin për testim me shkrim i datës 18.04.2025; Verifikimin paraprak i datës 21.03.2025; Formularin e rezultatit të testit me shkrim i datës 29.04.2025; Formularin e Intervistës me gojë i datës 07.05.2025; Formularin e rezultateve përfundimtare i datës 07.05.2025; Formularët e vlerësimit të kandidatet në intervistë me gojë datë 07.05.2025; Kërkesën për punësim e datës 05.03.2025 nga kandidatja F.M-N me dokumentacionin nga faqe 1-23; Testin me shkrim; Kërkesën për punësim e datës 24.02.2025 të kandidatës fituese me dokumentacionin nga faqe 1-20; Udhëzues për testin me shkrim i datës 24.04.2025; Kërkesën për punësim e datës 10.03.2025 të ankueses me dokumentacionin nga faqe 1-18; Emailin e datës 24.03.2025, 25.03.2025 nga ankuesja për KGJK.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, **sepse:**

Nga analizimi i provave të lëndës, rrjedhë se SKGJK-ja më datë 05.02.2025, ka shpallur Konkursin e Jashtëm Nr.01/2025, për njëqind e dy (102) pozita pune, duke përfshirë edhe pozitën e punës “Udhëheqës i Zyrës për Informim dhe Komunikim me Media” në Gjykatën Themelore në Pejë, Kategoria e Ulët Drejtuese, ku afati për aplikim ka qenë nga data 05.02.2025 deri më 06.03.2025.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja, të cilës i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk ka arsimin e kërkuar sipas konkursit apo të përafërt.

Sipas njoftimit të datës 07.05.2025 të Komisionit të Pranimit, për rezultatet përfundimtare, rezulton se si kandidatë të suksesshme janë shpallur A.Z- Ç me 91.26 pikë dhe F.M- N me 86.12 pikë.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka kundërshtuar refuzimin e aplikacionit me pretendimet se i është padrejtësi, sepse siç thuhet nga ankuesja Fakulteti Juridik nuk është fushë e përafërt me Fakultetin e Gazetares, mirëpo duke marr parasysh pozitën që ankuesja ka si gazetarë atëherë duhet të konsiderohet si i përafërt. Shton së SKGJK, nuk ka marr marr parasysh Vendimin A.nr.1204/2024 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e më të cilin vendim është konstatuar se kandidatja me më së shumti pikë nuk ka përvojë pune.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i aktit të shpalljes së konkursit Nr. 01/2025, për pozitën e punës “Udhëheqës i Zyrës për Informim dhe Komunikim me Media” në Gjykatën Themelore në Pejë, ka gjetur së si kualifikime arsimore, profesionale dhe përvojë e punës është përcaktuar: *Diploma universitare të vlefshme në Kosovë: e preferuar Fakulteti i Gazetarisë ose ndonjë fushë e përafërt; Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale.*

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit në pikëpamje të kompetencës lëndore të Këshillit për vendosje lidhur më këtë çështje administrative, ju referua nenit 6, paragrafi 4, të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë, i cili përcakton se: “4. Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura

kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë”, kështu që, nisur nga ky referim ligjor të punësuarit në administratë të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor kanë statusin e nëpunësit civilë më status të veçantë dhe së Këshilli Gjyqësor i Kosovës, si institucion i sistemit të drejtësisë ka rregulluar me akt të veçantë ligjor procedurën e pranimit të nëpunësve civilë në këtë institucion gjegjësisht me Rregulloren Nr. 01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Ndërlidhur si me lartë, Kolegji i Këshillit në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses mori parasysh dispozitat e Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, me theks të veçantë :

-Nenin 3, [Parimet për pranim]: *Pranimi në detyrë i të punësuarve në administratën e sistemit gjyqësor bazohet në procedurë të hapur dhe konkurruese duke siguruar profesionalizëm, integritet, mos-diskriminimin, transparencës, pavarësinë, paanshmërinë, meritokracinë, si dhe të pasqyroj natyrën shumë etnike dhe parimet e barazisë gjinore siç janë të garantuara në Kushtetutën e Republikës, marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe në ligjet e aplikueshme të Republikën e Kosovës.*

-Nenin 14, paragrafin 2 [Aplikacioni dhe dokumentet e nevojshme për aplikim]: *2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjesisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2 kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.....*

-Nenin 15, paragrafi 1 në paragrafi 1 [Procedura e pranimit]: *Procedura e pranimit për të gjitha kategoritë e të punësuarëve në administratën e sistemit gjyqësor fillon me konkurrim, i cili zhvillohet në dy (2) faza: 1.1. verifikimi paraprak përmes të cilit nga ana e NjMBNj verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit;*

-Nenin 16, paragrafin 1 dhe 2 [Verifikimi paraprak nga NjMBNj]: *Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NjMBNj, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit.*

- Nenin 17, paragrafi 1 dhe 2, [Vlerësimi profesional] *1. Vlerësimi profesional i kandidatëve, zhvillohet nga komisioni i pranimit dhe përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 2. Vlerësimi profesional i kandidatëve zhvillohet në dy faza: 2.1. Faza a parë: vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim; dhe 2.2. Faza e dytë: vlerësimi nëpërmjet intervistës me gojë. 3. NjMBNj, ofron mbështetje teknike dhe profesionale gjatë procedurës së konkurrimit, sipas kërkesës së komisionit të pranimit.*

-Nenin 23 paragrafi 1 dhe 2: *1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të fituara në testin me shkrim dhe intervistën me gojë. 2. Në përfundim të vlerësimit, komisioni i pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve emrin dhe mbiemri, numrin total të pikëve të fituara e cila është shuma e pikëve të fituara gjatë intervistës me shkrim dhe me gojë dhe kandidati fitues konsiderohet kandidati i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale të vlerësimit.*

Në kuptim të kuadrit ligjor si me lartë, dhe duke qenë së ankuesja kundërshton refuzimin e aplikacionit, Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar aplikacionin e ankueses të dorëzuar me rastin e aplikimit në këtë konkurs, ku dhe ka gjetur së e njëjta posedon Diplomën të datës 26.10.2016, për përfundimin të studimeve themelore më datë 30.06.2016, në Fakultetin Juridik, Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka” duke marr titullin Bachelor i Dritësisë, andaj, siç ishte konstatuar edhe më Vendimin e Këshillit A.nr.1204/2024 të datës 11.10.2024, Fakulteti Juridik nuk konsiderohet si Fakultet i ngjashme me Fakultetin e Gazetarisë, kështu që, në vlerësimin e Kolegjit, Njësia përgjegjëse në këtë rast Njësia e Personelit të SKGJK-së, më të drejtë ka refuzuar aplikacionin e ankueses, pasi që, e njëjta nuk plotëson kriterin e arsimit lidhur me pozitën përkatëse, dhe së mbi këtë konstatim akti i kundërshtuar për refuzim të aplikacionit është akt i nxjerrë në pajtim me nenin 16 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuere për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankueses se organi i punësimit nuk ka marr parasysh Vendimin e Këshillit A.nr.1204/2024 të datës 11.10.2024, e sipas të cilit vendim ishte konstatuar së kandidatja me më së shumti pikë nuk ka përvojën e punës, në ndërlidhje me këtë pretendim, Kolegji i Këshillit thekson faktin e pa kontestuar së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më Vendimin A.nr.1204/2024, të datës 11.10.2024, kishte vlerësuar se në konkursin paraprak kandidatja fituese znj. A. Z- Ç, lidhur me përvojën e punës kishte dorëzuar një shkresë pa datë dhe nuk evidentohet nëse është lëshuar nga biznesi apo kompania ku e njëjtë kishte punuar, dhe krahas kësaj kishte dorëzuar vetëm Pasqyrën nga Trusti Pensional për periudhën 17.08.2017 deri më datë 23.05.2024, pa dokumentacion tjetër mbështetës lidhur me përvojën e punës dhe për këtë arsye ishte konstatuar se e njëjta nuk ka plotësuar kriterin e konkursit sa i përket përvojës së punës. Ndërsa, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të kandidates në fjalë të dorëzuar në konkursin e Jashtëm Nr.01/2025 të datës 05.02.2025, e njëjta si dëshmi lidhur me kriterin e arsimit ka ofruar Diplomën Nr. 4264, të datës 18.07.2018, për përfundimin e studimeve themelore më datë 29.06.2018, në Fakultetin e Filologjisë-Programi Gazetari, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, duke marr titullin Bachelor i Gazetarisë. Ndërsa, lidhur me kriterin e përvojës se punës pas diplomimit ka dorëzuar Vërtetimin e datës 05.12.2024, të lëshuar nga First Media Group-Gazeta “Kosova Sot”, me të cilën konfirmohet së e njëjta nga data 01.11.2018 deri më datë 01.07.2019 ka qenë në marrëdhënie punës në këtë medium si Gazetare (1 vit e një muaj); Letër Dëshminë për përvojën e punës, të datës 27.11.2024, të lëshuar në Literal Media Sh.p.k sipas të cilës kandidatja fituese ka punuar si Gazetare nga data 01.08.2019 deri më datë 01.07.2020 (1 vit), ndërsa, nga data 01.07.2020 deri më datë 01.08.2021, ka punuar si Redaktore(1vit); Letër Dëshminë për përvojë të punës të lëshuar nga Qendra për Informim të Hapur “Syri”, sipas së cilës dëshmi e njëjta ka punuar në pozitën Gazetare nga data 01.07.2021 deri më datë 01.12.2023 (2 vite e 5 muaj pasi që në muajin korrik 2021 ka punuar njëkohësisht edhe si redaktore të Literal Media Sh.p.k), si dhe Deklaratën Zyrtare për përvojë të punës të datës 05.12.2024, të lëshuar nga EATITKS SH.P.K. Baboon Delivery e njëjta ka punuar në pozitën Udhëheqëse e Shërbimit të Klientit, nga data 01.10.2023 deri më datë 01.08.2024 (8 muaj, pasi që në periudhën kohore tetor-dhjetor 2023 e njëjta ka përvojë punës si gazetare të Qendra për Informim të Hapur “Syri”), Kështu që, pas analizimit të këtyre provave, Kolegji i Këshillit, konstaton se kandidatja fituese ka përmbushur kriterin arsimit dhe përvojës së punës, përvojë të cilën e ka argumentuar me edhe më dëshmi shtesë gjegjësisht më Pasqyrë të Trustit Pensional dhe dëshmi nga Administrata Tatimore. ashtu qw tw dhënat nga këto dy dokumente zyrtare janë në përputhje më tw dhënat e deklaruar sipas dëshmime mbi përvojën e punës tw evidentuar si me sipër.

Për me tepër, Kolegji i Këshillit në përmbushje të mandatit kushtetues dhe ligjor të Këshillit lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, Kolegji ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë edhe veprimet administrative të ndërmarra në fazën e vlerësimit profesional të kësaj procedure dhe si rrjedhojë Kolegji nuk ka arritur të evidentoj shkelje esenciale ligjore e të cilat si të tilla do ta cenonin vlefshmërinë ligjore të kësaj procedure.

Andaj, nisur nga rrethanat dhe konstatimet e dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, Kolegjit të Këshillit erdhi në përfundimin e se procedura e pranimit sipas Konkursit të jashtëm Nr.01/2025 të datës 05.02.2025 për pozitën *Udhëheqës i Zyrës për Informim dhe Komunikim me Media* në Gjykatën Themelore në Pejë, është zhvilluar në plotëni me parimet e përgjithshme të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, kështu theksuar si më lartë, e në kuptim të nenit 16, paragrafi 3 dhe nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.968/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankueses Dardane Kastrati;*
- *Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në SKGJK; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*